PROMOVIM

## Një libër që hedh dritë mbi vitet e largëta të historisë

# "24 perandorë dhe katër Papë shqiptarë në krye të Romës"

**Në këtë libër, që kritika italiane e ka pagëzuar si "TRIUMFIN E ANTIKITETIT SHQIPTAR", gjenden fakte nga më interesantet, të cilat kanë fjetur për shekuj të tërë në bibliotekat më prestigjoze të Europës, pikërisht ku i është dashur të "gërmoj" autorit, duke u nisur nga Vatikani**

Pas tre edicioneve të suksesshme në italisht, doli nga shtypi në gjuhën shqipe, libri më i njohur i shkrimtarit shqiptar me banim në Itali (Rimini) Dr. Alban Krajës me titull:

"24 PERANDORE DHE KATER PAPE SHQIPTARË NE KRYE TE ROMES"

Përurimi i këtij libri është bërë dje në ambjetin e hotel "Sheraton" në Tiranë.

Në këtë libër mjafton vetëm titulli për të kuptuar madhështinë e racës tonë ngadhnimtare iliro-shqiptare, por nukështeë vetëm kaq. Në këtë libër që kritika italiane e ka pagëzuar si "TRIUMFIN E ANTIKITETIT SHQIPTAR", gjenden fakte nga më interesantet, të cilat kanë fjetur për shekuj të tërë në bibliotekat më prestigjoze të Europës, pikërisht ku i është dashur të "gërmojë" autorit, duke u nisur nga Vatikani e duke përshkruar Francën, Spanjën për të mbaruar në Vjene dhe Pragë.

Në këtë volum ndërtohet me saktësi të paparë antikiteti shqiptar nga shekulli i XII para K. e deri në shekullin e IV pas K. Gjithashtu jepen me saktësi matematike, datëlindjet dhe vendlindjet e të 24 perandorëve iliro-shqiptar, ku mes tyre spikat më i rëndësishmi: Perandori shqiptar, i biri i një shënjtjeje shqiptare (Shën Elena), Costandino Magno i lindur në Nish, i cili është dhe themeluesi i perandorisë Romano-Kristiane, pas një persekutimi tre shekullor ndaj kristianëve të ndjekur nga perandorët e mëparshëm. Po në këtë libër, duke iu referuar glotologut më të shquar të shekullit të kaluar në Itali, Prof Ribezzo, pas zbulimit nga ana e tij të shkrimeve Mesapike në Puglia, gjuha shqipe datohet e shkruar që në shekullin e IV para Krishtit, pra aksi i datimit i të shkruarit shqip spostohet në një hark kohor prej dy mijë vjetësh, duke pasur parasysh që gjuhëtarët tanë kanë vazhduar për vite të njohin shqipen të datuar vetëm në vitin 1555!!!

Mes të tjerave në këtë volum, vërehen dhe emrat e papëve të shquar shqiptar si San Eleuterio, san kaio Giovani i katër, e shqiptari Gjon Francesk Albani, i njohur me emrin e Klementit të XI.

Në fund mund t'ju them që ia vlen me të vërtetë ta bëjmë tonën gjithsesi është shkruar në këtë libër e të marrim nder e lavdi nga të parët e kombit tonë, bashkëthemelues i Europës Antike.

**Vitore (Stefa) LEKA**

### Një biografi të shkurtër për Dr.Alban Krajën

Ka lindur në vitin 1970 në Shkodër, ku është diplomuar në degën Gjuhë -Letërsi të Universitetit "Luigj Gurakuqi". Është një ndër pionierët e gazetarisë së pavarur në Shqipërinë e pas diktaturës. Që nga nëntori i vitit 1993 jeton në Itali dhe nga viti 1996 është president i Shoqatës Iliria, shoqatë e shqiptarëve që banojnë në Itali, me seli në Rimini.

Falë angazhimit të tij social, është zgjedhur nga këshilli "Qytetar i krahinës së Riminit, përgjegjës i sekretarisë për marrëdhëniet me jashtë të shoqatave të solidaritetit dhe pjesëtar i këshillit krahinor mbi emigrimin e drejtuar nga Prefekti i Riminit. Në vitin 2002 është zgjedhur president i këshillit të parë të emigrantëve në Itali me qendër në Rimini.

Në mars të vitit 2004 shoqatat shqiptare dhe arbëreshe në Itali, e kanë zgjedhur President të "Lidhjes nacionale të shoqatave shqiptaro-arbëreshe në Itali.

Në dhjetor të 2004 Unioni i Gazetarëve të Veriut, e ka shpallur anëtar nderi të saj.

Falë provojës në fushën e çështjeve politike, shoqërore të Europës Lindore, dhe veçanërisht të Ballkanit, bashkëpunon me organet e shtypit italian, shqiptar dhe të huaj. (Dott Kraja flet me gramatikë pesë gjuhë të huaja)

Në vitin 1999 ka botuar në Itali, studimin historik "Kosova-Mbijetesa e një populli". Dhe në vitin 2003 po në Itali ka botuar romanin historik "Skënderbeg-Fushata e Italisë. Gjithashtu libri i tij "24 perandorë e katër Papë shqiptarë në krye të Romës. "Pas një interesimi të gjerë të lexuesit italian ky libër është botuar dhe ribotuar tre herë në Itali. Aktualisht është pranë botimit të tij të ri "Iliria-Arbëria-Albania".

## Botohet libri "Basketbolli në Elbasan"

*Basketbollistët dhe sportdashësit elbasanas, por edhe ata shqiptarë, do të kenë mundësinë të ndjehen kuriozë të njihen me librin e fundit të ish-trainerit të basketbollit, elbasanasit Skënder Qorri, që tashmë ka dalë në dritë. Libri "Basketbolli në Elbasan" vjen në duart tona si një top i bukur në 80-vjetorin e skuadrës së parë të këtij lloj sporti në kryeqytetin e arsimit dhe të kulturës.*

*Është një studim që flet se si u njohën dhe u zhvilluan sportet e lojërave me dorë, kryesisht basketbolli në Elbasan. Përpjekjet e njeriut që një pjesë të jetës e kaloi me sportin e basketbollit, janë një mozaik në sfondin e botimeve për këtë sport që kishte vatra të ndryshme, ku edhe mund të zhvillohej, po aq sa edhe volejbolli.*

*Çdo faqe e këtij libri modest është një përpjekje intelektuale e një studiuesi jo vetëm për sportin që ndihmon ndjeshëm në njohjen e ecurisë dhe të personaliteteve që i dhanë jetë basketbollit, po aq sa edhe volejbollit. Ka qenë viti 1925 kur për herë të parë në Shqipëri, basketbolli u fut në përbërjen e lëndës së edukimit fizik në shkollën "Normale", krahas edhe sportit të futbollit që kishte përfaqësuesit e vet në këtë shkollë, që më pas do të ishte edhe universiteti i parë shqiptar.*